

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT
I
AVOKATIT TË POPULLIT

Ankesa nr.700/2020

Islam Morina
kundër

Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
përkitazi me pretendimet e ankesës për mospërgjigje në kërkesë dhe ankesë

Drejtuar:

Z. Liburn Aliu, ministër

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Kopje për:

Z. Habit Hajredini, drejtor

Zyra për Qeverisje të Mirë- Zyra e Kryeministrit

Prishtinë, më 24 shkurt 2022

Qëllimi i raportit

1. Objekti i çështjes së Raportit me rekomandime është vlerësimi i veprimeve dhe i mosveprimeve të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), asokohe Ministria e Infrastrukturës (MI), si autoritet përgjegjës në lidhje me trajtimin e kërkesës së z. Islam Morinës (në tekstin e mëtejshëm: ankuesi), nëpërmjet së cilës ka kërkuar të pajisej me certifikatën e kontributit pensional dhe mbajtjes në burim të tatimit në paga, si dhe trajtimin e ankesës së tij për të njëjtën çështje.
2. Raporti me rekomandime ka për qëllim të tërheqë vëmendjen dhe të japë rekomandime specifike dhe konkrete lidhur me veprimet që MMPHI-ja duhet t'i ndërmarrë për respektimin e plotë të ligjeve në fuqi dhe të të drejtave të njeriut.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: “*Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.*” Ndërsa në nenin 135, paragrafi 3, përcakton: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*” Avokati i Popullit, bazuar në Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ndër të tjera, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- “*Për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit*” (neni 16, paragrafi 1);
- “*të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla*” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2);
- “*t'u rekomandojë Qeverisë, Kuvendit dhe autoriteteve tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit*” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5);
- “*t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta*” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6).

Përshkrimi i rastit

4. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 23 nëntor 2020 e ka pranuar ankesën e z. Islam Morinës parashtruar kundër Ministrisë së Infrastrukturës (MI) për mospërgjegje në kërkesë dhe ankesë.
5. Sipas pohimeve të ankuesit dhe të dokumentacionit të paraqitur në IAP, ankuesi nga data 20 nëntor 2017 e deri më 30 shtator 2019 kishte punuar me kontratë për shërbime të veçanta në Divizionin për Komunikim me Publikun në MI. Më 6 mars 2020 ankuesi

nëpërmjet kërkesës (nr. 2684) drejtuar MI-së kishte kërkuar të pajisej me certifikatën e kontributit pensional dhe mbajtjes në burim të tatimit në paga, për periudhën e punësimit të tij në MI. Meqë ankuesi nuk kishte marrë përgjigje në këtë kërkesë, ai më 24 qershor 2020 e kishte përsëritur kërkesën e tij nëpërmjet postës elektronike. Duke qenë se ankuesi edhe në këtë shkresë nuk kishte marrë përgjigje, ai më 8 korrik 2020 i ishte drejtuar MI-së me ankesë për mospërgjigje në kërkesë.

6. Më 16 korrik 2020, ankuesi nëpërmjet postës elektronike kishte marrë përgjigje nga zyrtarja e kontabilitetit në këtë ministri, nëpërmjet së cilës ishte njoftuar se zyrtarja në fjalë nuk ishte kompetente të lëshonte certifikatën e kontributit pensional dhe mbajtjes në burim të tatimit në paga dhe se kompetentë për këtë çështje ishin zyrtarë të tjerë në ministri.
7. Më 19 gusht 2020 ankuesi përsëri i ishte drejtuar ministrisë me ankesë.
8. Ankuesi ka thënë se deri më paraqitjen e ankesës së tij në IAP, asnjëherë nuk kishte marrë ndonjë përgjigje nga MMPHI-ja në kërkesën dhe ankesën e tij.

Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit

9. Më 6 janar 2021, përfaqësuesja e IAP-së, nëpërmjet postës elektronike i është drejtuar me shkresë sekretarit të përgjithshëm të MMPHI-së, nëpërmjet së cilës ka kërkuar informata për arsyen e mospërgjigjes në kërkesën e ankuesit dhe për veprimet që kjo ministri i ka ndërmarrë apo që planifikon t'i ndërmarrë përkitazi me çështjen.
10. Më 1 shkurt 2021, përfaqësuesja e IAP-së, nëpërmjet postës elektronike i është drejtuar me shkresë rikujtuese sekretarit të përgjithshëm të ministrisë.
11. Më 4 mars 2021, përfaqësuesja e IAP-së, nëpërmjet postës elektronike i është drejtuar me shkresë rikujtuese sekretarit të përgjithshëm të MMPHI-së.
12. Më 4 mars 2021, sekretari i përgjithshëm i MMPHI-së, shkresën e marrë nga përfaqësuesja e IAP-së ua ka dërguar zyrtarëve kompetentë të ministrisë nëpërmjet postës elektronike dhe u ka kërkuar të vepronin në përputhje me legjislacionit në fuqi dhe brenda kompetencave ligjore përkitazi me çështjen. Përveç këtij komunikimi për të cilin është njoftuar përfaqësuesja e IAP-së, IAP-ja nuk ka marrë asnjë përgjigje nga MMPHI-ja.
13. Më 21 maj 2021, ankuesi është njoftuar për veprimet e IAP-së përkitazi me lëndën e tij. Për më tepër, ankuesi e ka njoftuar përfaqësuesen e IAP-së se ende nuk ka marrë përgjigje nga ministria në kërkesat e tij.

Baza ligjore

14. Neni 21, paragrafët 2 dhe 3, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) përcakton si në vijim: *“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”*
15. Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në nenin 73, paragrafi 1, përcakton: *“Përveçse kur ligji parashikon një formë të caktuar, kërkesa e palës për fillimin e procedurës administrative mund të bëhet: 1.1. në formë të shkruar, 1.2. me gojë përpara organit publik dhe të regjistrohët në procesverbal nga organi publik, ose 1.3. në çdo formë tjetër të përshtatshme dhe të mundshme.”*

16. Paragrafi 1 i nenit 74 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton: “Një kërkesë mund të parashtrohet drejtpërdrejt në organin publik të cilit i drejtohen, po ashtu edhe në organet e tij lokale, nëse ka të tilla.” Ndërsa paragrafi 5 përcakton: “Një kërkesë me shkrim, gjithashtu mund të parashtrohet me postë apo në mënyrë elektronike drejtpërdrejt në adresën zyrtare të organit të cilit i drejtohet.[...].”
17. Paragrafi 1 i nenit 75 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton: “Kur një organ publik merr një kërkesë me shkrim që është jashtë kompetencave të veta, pa vonesë do t’ia kalojë kërkesën organit kompetent dhe do të njoftojë dërguesin për këtë.”
18. Paragrafi 1 i nenit 98 [Afati për përfundimin e procedurës administrative] i Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton: “Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.” Ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet si në vijim: “Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj.”
19. Paragrafi 1 i nenit 124 [Legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative] të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton: “1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim.[...].”
20. Paragrafi 1 i nenit 125 [Ankesa] të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton: “1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: “heshtja administrative”).”
21. Paragrafi 1 i nenit 135 [Afati për njoftimin e aktit që zgjidh ankesën] të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton: “1. Përpos kur ligji parasheh një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës.”
22. Ligji nr. 05/l-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, neni 38 [Mbajtja në burim e tatimit në paga dhe mbajtja në burim e kontributeve], në paragrafin 6, përcakton: “Secili punëdhënës apo person që kërkohet të mbajë në burim sipas paragrafit 4¹ të këtij neni, deri më 1 mars të vitit vijues të periudhës tatimore, i siguron secilit të punësuar nga i cili tatimi në paga është mbajtur në burim, një certifikatë të tatimit të mbajtur në burim në formën e specifikuar në aktin nën ligjor të lëshuar nga Ministri.”
23. Udhëzim Administrativ nr. 01/2016 për zbatimin e Ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, neni 42 [Dispozitat e përgjithshme që aplikohen për tatimet e mbajtura në burim], paragrafi 3, përcakton si në vijim: “Tatimpaguesi i cili mban tatimin

¹4. Pensionet e paguara nga apo për interes të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, apo nga një fond i autorizuar plotësues i pensioneve i rregulluar me legjislacionin përkatës mbi kontributet pensionale, si dhe sigurimet shëndetësore sipas Ligjit për Sigurimin Shëndetësor, i nënshtrohet mbajtjes së tatimit në burim nga paguesi i pensioneve si dhe sigurimeve shëndetësore, të tilla në shkallët e parapara në nenin 6 të këtij ligji.”

në burim sipas Kapitullit IX të Ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale, gjatë një periudhe tatimore, me kërkesë të pranuesit të të ardhurave, është i obliguar të pajis të njëjtin me certifikatën e tatimit të mbajtur në burim, në formën e specifikuar nga ATK.”

Analiza ligjore

24. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj zbatimi, respektimi dhe përmbushja e këtyre të drejtave është me interes dhe i kontribuon funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 21 shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve për t'i respektuar liritë dhe të drejtat e të tjerëve dhe si i tillë ky parim është domosdoshmëri e kohës dhe duhet të respektohet nga të gjithë.
25. Kushtetuta në nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] përcakton qartë: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”* Në këtë drejtim Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative e përcakton shprehimisht të drejtën e ushtrimit të mjeteve juridike administrative, i cili në nenin 124, paragrafi 1, shprehimisht përcakton: *“Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim.[...]”*
26. Ndër parimet bazë të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative janë edhe parimi i ligjshmërisë, parimi i joformalitetit dhe i efikasitetit të procedurës administrative, parimi i informimit, i ndihmës aktive dhe parimi i së drejtës për mjete juridike. Parimi i ligjshmërisë (neni 4, paragrafi 1) së organeve të administratës kërkon: *“Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.”* Ndërsa në paragrafin 2 përcakton: *“2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj.”* Bazuar në dispozitat në fjalë, procedurat administrative duhet të zhvillohen në mënyrë të tillë që të respektohen dhe të mbrohen të drejtat subjektive dhe interesat e ligjshme të të gjithë personave të përfshirë. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit, që do të thotë se e gjithë veprimtaria e organeve publike duhet të jetë në përputhje me ligjin.
27. Parimi i joformalitetit dhe i efikasitetit të procedurës administrative, në nenin 10, paragrafi 2, definojnë qartë: *“Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative.”* Zbatimi i plotë i kërkesave dhe i dispozitave të ligjit duhet të shihet si funksioni më i rëndësishëm i organeve administrative. Funksionet duhet t'i mbrojnë dhe t'i promovojnë interesat publike si dhe interesat e ligjshme të personave. Respektimi dhe mbrojtja e këtyre interesave nënkupton përmbushjen dhe ushtrimin e detyrave ligjore në mënyrë efikase, të drejtë dhe të përshtatshme dhe sa më shpejt që të jetë e mundur.
28. Parimi i së drejtës në mjete juridike thekson rëndësinë duke e vënë në parim ushtrimin e mjeteve juridike administrative si e drejtë e gjithsecilit: *“Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi*

administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik.” (neni 13).

29. Avokati i Popullit rikujton se procedura administrative definohet, para së gjithash, si tërësi e normave juridike me të cilën rregullohet mënyra e sjelljes së organeve shtetërore, organe këto të cilat, duke i aplikuar normat e së drejtës materiale, nxjerrin akte administrative me të cilat vendosin për të drejtat, për obligimet ose për interesat e subjekteve përkatëse të së drejtës.
30. Avokati i Popullit vëren se Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në nenin 75, paragrafi 1, definojnë qartë: *“Kur një organ publik merr një kërkesë me shkrim që është jashtë kompetencave të veta, pa vonesë do t’ia kalojë kërkesën organit kompetent dhe do të njoftojë dërguesin për këtë.”* Rrjedhimisht kjo dispozitë për qartësimin e kompetencave vlen edhe për organet/njësitë organizative brenda të njëjtit institucion. Nga përgjigjja të cilën ankuesi e kishte marrë më 16 korrik 2020 nga zyrtarja e kontabilitetit në këtë ministri, nëpërmjet së cilës e kishte informuar ankuesin se ajo nuk ishte kompetente për trajtimin e kërkesës së tij, por kompetentë për këtë çështje janë zyrtarë të tjerë në ministri, e njëjta nuk kishte njoftuar nëse të njëjtën kërkesë e kishte dërguar tek zyrtari kompetent, duke e lënë kërkesën e ankuesit pa epilog. Rikujtojmë se në rast të ndonjë konflikti për kompetencë brenda të njëjtit institucion, konflikti për kompetencë duhet zgjidhur me korrektësi dhe profesionalizëm në mënyrë që të mos krijohen situata të tjera juridike dhe duke i shmangur vonesat e procedurës administrative. Një rregull e përgjithshme dhe efektive hap perspektiva të reja relevante në proceset avancuese të bashkëpunimit gjithnjë e më cilësor mes organeve të administratës dhe palëve në procedurë. Për më tepër, rikujtojmë se Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në nenin 26, paragrafët 1 dhe 2, përcakton si në vijim: *“1. Organi publik kompetent, në një procedurë administrative, vepron nëpërmjet zyrtarit përgjegjës të përcaktuar sipas këtij neni. 2. Nëse nuk është përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë, me akt nënligjor apo me rregullat e brendshme administrative të organizimit, titullari i organit publik, cakton paraprakisht, në përputhje me rregullat e organizimit të brendshëm, një njësi përgjegjëse për çdo lloj të procedurës administrative në kompetencë të organit. Vendimi bëhet publik me mjete të përshtatshme, përfshirë ueb-faqen e organit publik.”*
31. Avokati i Popullit rikujton se procedurat administrative duhet të kryhen në përputhje të plotë me Ligjin nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përveç të tjerash definojnë se procedura administrative nisur sipas kërkesës do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe, në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj (neni 98, paragrafët 1 dhe 2).
32. Në këtë rast, mospërgjigjja e ministrisë në kërkesën e ankuesit ka krijuar situata të tjera juridike në procedurë administrative, pasi mospërgjigjja e ministrisë në kërkesën e z. Morinës ka orientuar të njëjtin si palë në procedurë administrative në iniciimin e procedurave ankimore për mospërgjigje në kërkesë për të cilën gjithashtu nuk kishte marrë përgjigje. Avokati i Popullit rikujton se ankesa, si mjet i rregullt juridik në procedurë administrative, që është e drejtë ndaj çdo mosveprimi administrativ, rregullohet shprehimisht me Ligjin nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Në këtë drejtim organet publike janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe në kushtet e

caktuara me ligj. Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në nenin 135 [Afati për njoftimin e aktit që zgjidh ankesën], në paragrafi 1, shprehimisht përcakton: “Përpos kur ligji parasheh një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës.”

33. Avokati i Popullit ju sjell në vëmendje se sipas Ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, secili punëdhënës është përgjegjës të mbajë në burim tatimin nga pagat e tatueshme të paguara punëtorëve të tij, duke përfshirë edhe pagesat për shërbimet profesionale, teknike, të menaxhimit, financiare, pagesat për kontratat mbi vepër etj. [...]. Për më tepër, neni 38, paragrafi 6, i ligjit obligon çdo punëdhënës që t’i sigurojë secilit të punësuar një certifikatë të tatimit të mbajtur në burim: “*Secili punëdhënës apo person që kërkohet të mbajë në burim sipas paragrafit 4 të këtij neni, deri më 1 mars të vitit vijues të periudhës tatimore, i siguron secilit të punësuar nga i cili tatimi në paga është mbajtur në burim, një certifikatë të tatimit të mbajtur në burim në formën e specifikuar në aktin nën ligjor të lëshuar nga Ministri.*” Mbështetur në bazën ligjore të cituar më lart, Avokati i Popullit vlerëson se kërkesa e ankuesit drejtuar ministrisë, nëpërmjet së cilës kishte kërkuar të pajisej me certifikatën e kontributit pensional dhe mbajtjes në burim të tatimit në paga, për periudhën e punësimit të tij në ministri, ishte kërkesë plotësisht e mbështetur me ligj dhe si e tillë është e drejtë e secilit të punësuar e garantuar me ligj.
34. Për më tepër, obligimi i tatimpaguesit për pajisjen e pranuesit të të ardhurave me certifikatën e tatimit të mbajtur në burim, në formën e specifikuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, rregullohet edhe me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2016 për zbatimin e Ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, i cili në nenin 42 [Dispozitat e përgjithshme që aplikohen për tatimet e mbajtura në burim], paragrafi 3, përcakton si në vijim: “*Tatimpaguesi i cili mban tatimin në burim sipas Kapitullit IX të Ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale, gjatë një periudhe tatimore, me kërkesë të pranuesit të të ardhurave, është i obliguar të pajis të njëjtin me certifikatën e tatimit të mbajtur në burim, në formën e specifikuar nga ATK.*”
35. Në anën tjetër, Avokati i Popullit rikujton se mospërgjigjja e MI-së në shkresat e IAP-së përkitazi me këtë rast, është padyshim mosbashkëpunim i këtij institucioni me IAP-në në hetimit të këtij rasti. Në këtë aspekt Avokati i Popullit rikujton se neni 132 i Kushtetutës, në paragrafin 3, përcakton: “*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.*” Kurse Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, në nenin 18, paragrafi 6, përcakton: “*Avokati i Popullit ka qasje në dosjet dhe në dokumentet, te çdo autoriteti të Republikës së Kosovës, duke përfshirë dosjet mjekësore për personat e privuar nga liria, në pajtim me ligj, dhe mund t’i shqyrtojë ato lidhur me rastet që i ka në shqyrtim dhe sipas këtij ligji, mund të kërkojë nga çdo autoritetet i Republikës së Kosovës dhe nga personeli i tyre të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, duke siguruar informacione relevante, përfshirë edhe kopjen e plotë apo të pjesshme të dosjes dhe dokumenteve sipas kërkesës së Avokatit të Popullit*”; ndërsa në nenin 25, paragrafi 2, përcakton: “*Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil*”; ndërkaq paragrafi 3 i këtij neni përcakton:

“Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyjë në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore, për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare.”

Konstatimet e Avokatit të Popullit

- Avokati i Popullit, bazuar në të gjeturat më lart, konsideron se mospërgjegjja e ministrisë në kërkesën e z. Morinës për pajisje me certifikatën e kontributit pensional dhe mbajtjes në burim të tatimit në paga, për periudhën e punësimit të tij në MI, është në kundërshtim me Ligjin nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Mosarritja e organit kompetent që veprimet e tij në çështjen konkrete t’i mbështesë në parimin e ligjshmërisë, në parimin e joformalitetit dhe të efikasitetit, në parimin e informimit dhe të ndihmës aktive, si parime bazë që sigurojnë funksionimin e shtetit demokratik, është tregues i qartë i shkeljes së të drejtave të ankuesit për sigurimin e një procesi efektiv administrativ në përputhje me ligjin.
- Avokati i Popullit konsideron se mospërgjegjja dhe mostrajtimi i ankesës së z. Morinës, përkitazi me mospërgjegje në kërkesë, është në kundërshtim me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkitazi me dispozitat e përgjithshme për mjetet juridike administrative si dhe me rregullat e përgjithshme dhe kushtet për trajtimin e ankesës.
- Sipas Avokatit të Popullit, vonesat për përgjegje në kërkesat/ankesat e palës në procedurë administrative bien ndesh me parimin e efikasitetit të procedurës së përgjithshme administrative e përcaktuar me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili në nenin 10, paragrafi 2, shprehimisht saktëson: *“Organi publik zhvillon procedurën administrative sa më shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative.”*
- Duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë, domosdoshmërinë e trajtimit të çdo kërkesë dhe të mjeteve juridike administrative në harmoni të plotë me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Avokati i Popullit vlerëson se çdo mosveprim i organit publik në këtë drejtim përbën shkelje të së drejtës për një proces të rregullt dhe efektiv në procedurë administrative.
- Po ashtu Avokati i Popullit konsideron se mosveprimi i ministrisë për sigurimin e certifikatës së kontributit pensional dhe mbajtjes në burim të tatimit në paga, për periudhën e punësimit të ankuesit në MI, është në kundërshtim me Ligjin nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale si dhe në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2016 për zbatimin e Ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.
- Andaj, bazuar në të gjeturat më lart, Avokati i Popullit konstaton se në rastin e z. Morinës, MI-ja kishte dështuar t’i përmbushte obligimet ligjore që buronin nga Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nga Ligji nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.

Bazuar në atë që u tha më sipër, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3², të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit³, i


REKOMANDON

Ministrisë së Infrastrukturës:

- ***T'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme përkitazi me kërkesën e ankuesit dhe t'i përgjigjet atij, në pajtim me Ligjin nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe me Ligjin nr. 05/l -028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Naim Qelaj

Avokat i Popullit

² Neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”

³ Neni 18, paragrafi 1.2, i Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: “(...) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (...).”